



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Nr. 2474/11 Prot

Tiranë, më 01/10 /2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.309 prot, datë 24.09.2020 “Njoftim për vend të lirë pune” të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Elbasan, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2474 prot, datë 29.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 02.10.2020, si më poshtë:

Pozicionet e punës:

- 1 mësimdhënës i formimit teorik – praktik në drejtimin Sisteme sigurie automatizimi rrjetit të internetit, Instalues elektrik (Elbasan)
- 1 mësimdhënës i formimit teorik – praktik në drejtimin Parukeri – Estetik (Elbasan)
- 1 mësimdhënës i formimit teorik – praktik në drejtimin Kuzhinë (Elbasan)
- 1 mësimdhënës i formimit teorik – praktik në drejtimin përpunues qumështi dhe prodhues të produkteve dhe nënprodukteve të tij, përpunues i frutave dhe perimeve, Degustues dhe klasifikues të ushqimeve dhe pijeve (Elbasan)

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Elbasan

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit

- a) letër motivimi për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
- c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
- d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;
- e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Elbasan, brenda datës 13.10.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

